

Njoftim për shqyrtimin e pranueshmërisë për moshën nëntëmbëdhjetë (19) vjeç

Data

EMRI DHE ADRESA E KLIENTIT

EMRI DHE ADRESA E PËRFAQËSUESIT
TË KLIENTIT

RE: **Njoftim për shqyrtimin e pranueshmërisë për moshën nëntëmbëdhjetë (19) vjeç**

Aktualisht ju pranoheni për Developmental Disabilities Administration (DDA). Pranueshmëria juaj me DDA duhet të shqyrtohet para se të bëheni njëzet (20) vjeç. Informacionet që kemi mund të mos jenë të mjaftueshme që ju të vazhdoni të pranoheni për DDA sipas një prej kushteve të mëposhtme: aftësi të kufizuara intelektuale, palsi cerebrale, epilepsi, autizëm, ose ndonjë problem tjetër neurologjik **apo** sëmundje tjetër e ngjashme me aftësitë e kufizuara intelektuale. Kemi bashkëngjitur tabelën për dokumentacionin e nevojshëm që t'ju tregojmë se çfarë duhet.

Çfarë duhet të bëni?

DDA do t'ju dërgojë me kënaqësi informacionet e nevojshme për këtë ripërcaktim. Nëse doni që DDA të dërgojë informacion, ju lutemi plotësoni formularin e bashkëngjitur të aprovimit si më poshtë:

1. Shkruani emrat e vendeve, ofruesve dhe objekteve për të cilët mund të kërkojmë informacion në formularin e aprovimit. Përfshini informacionet e kontaktit për të gjithë ata që janë renditur në formularin e aprovimit.
2. Nënshkruani dhe vendosni datën në formularin e aprovimit, dhe
3. Kthejani formularin DDA.

Çfarë ndodh nëse nuk i përgjigjem kësaj kërkesë?

Ju lutemi përgjigjuni sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 90 ditë para se të bëheni njëzet (20) vjeç. Nëse nuk dëgjojmë prej jush, do të shqyrtojmë pranueshmërinë tuaj duke përdorur informacionet që kemi në dosjen tuaj si klient. Nëse nuk ka informacione të mjaftueshme për të konfirmuar vendimin lidhur me pranueshmërinë tuaj, atëherë pranueshmëria juaj për DDA do të vendoset kur të bëheni 20 vjeç.

Nëse keni pyetje, kontaktoni:

EMRI

NUMRI I TELEFONIT

ADRESA E EMAIL-IT

Mund ta gjeni një kopje të rregullave shtetërore lidhur me pranueshmërinë (WAC 388-823) me kërkesë ose online në <https://www.dshs.wa.gov/dda/consumers-and-families/eligibility>.

Shtojca: Tabela e dokumentacionit të nevojshëm
Formular aprovimi (DSHS 14-012)

cc: Dosja e klientit

Tabela e dokumentacionit të nevojshëm

Aftësitë e kufizuara	Diagnostikimi	Mjeku diagnostikues	Dokumentacioni i nevojshëm
Aftësi të kufizuara intelektuale	Aftësi të kufizuara intelektuale	Një psikolog i licencuar, një psikolog shkolle i certifikuar nga Uashington ose psikolog tjetër shkolle i certifikuar nga National Assoc. of School Psychologists	Raporti i plotë psikologjik ku përfshihet një rezultat i plotë i shkallës IQ prej më shumë se dy devijimesh standarde nën mesataren dhe rezultate të testit të aftësive përshtatëse prej më shumë se dy devijimesh standarde nën mesataren, dhe i plotësuar brenda 36 muajve të fundit.
Palsi cerebrale	Palsi cerebrale Kuardiplegji Hemiplegji Diplegji	Mjeku i licencuar	Nisja para moshës 3 vjeç, dhe informacione që mbështetin nevojën për asistencë fizike të drejtpërdrejtë në dy ose më shumë fusha (tualeti, dushi, të ngrënit, të veshurit, lëvizjet ose komunikimi).
Epilepsi	Epilepsi ose Çrregullim krizash	Neurolog i certifikuar	Diagnostikimi i bazuar në historinë mjekësore dhe testimet neurologjike, konfirmimi nga mjeku ose neurologu për ekzistencën e krizave të pakontrolluara dhe të vazhdueshme ose të ripërsëritura, dhe testi i aftësive përshtatëse që tregon kufizimet në funksionimin përshtatës të më shumë se dy devijimeve standarde nën mesataren.
Autizëm (sipas DSM-IV-TR)	Autizëm ose çrregullim autizmi Sipas 299.00 në DSM-IV-TR	Një psikolog i licencuar, një mjek i licencuar ose një ARNP i lidhur me një qendër autizmi, qendër zhvillimi, ose qendër ekselence, i një Bordi të Certifikuar: neurolog, psikiatër ose mjek për zhvillimin dhe sjelljen e fëmijës.	Vlerësim i plotë sipas DSM-IV-TR i cili përmbush të gjitha kriteret e diagnostikimit, prova të vonesës ose funksionimit jonormal para moshës 3 vjeç në aftësitë sociale, gjuhësore dhe komunikuese ose të luajtjes simbolike apo imagjinuuese, dhe teste të aftësive përshtatëse që tregojnë kufizime të konsiderueshme në funksionimin përshtatës në më shumë se dy devijime standarde nën mesataren.
Çrregullimi i spektrit të autizmit (sipas DSM-5)	Çrregullimi i spektrit të autizmit 299.0 Sipas DSM-5 duke përfshirë nivelet 2 ose 3 në të dyja kolonat	Një psikolog i licencuar, një mjek i licencuar ose një ARNP i lidhur me një qendër autizmi, qendër zhvillimi, ose qendër ekselence, i një Bordi të Certifikuar: neurolog, psikiatër ose mjek për zhvillimin dhe sjelljen e fëmijës.	Vlerësim i plotë sipas DSM-V i cili përmbush të gjitha kriteret e diagnostikimit, prova të vonesës ose funksionimit jonormal para moshës 3 vjeç me një nivel 2 ose 3 në të dyja kolonat e shkallës së nivelit, testi i aftësive përshtatëse i cili tregon kufizime të konsiderueshme në funksionimin përshtatës të dy ose më shumë devijimeve standarde, dhe FSIS i një devijimi standard ose më shumë nën mesataren - ose - përmbush të gjitha kriteret për çrregullimin e autizmit 299.0 sipas DSM-IV.
Një sëmundje tjetër neurologjike ose sëmundje tjetër e ngjashme që lidhet me aftësitë e kufizuara intelektuale	Çrregullim neurologjik ose kromozomial që njihet se shkakton defiçite në aftësitë intelektuale dhe përshtatëse	Mjeku i licencuar	Rezultati i plotë i shkallës IQ i më shumë se 1,5 devijimeve standarde nën mesataren dhe testi i aftësive përshtatëse që tregon kufizime të konsiderueshme në funksionimin përshtatës të më shumë se dy devijimeve standarde nën mesataren.

Shënim: Ky formular është vetëm një udhëzues i përgjithshëm dhe DDA mund të ketë nevojë për informacione ose vlerësime shtesë. Ky dokumentacion është hapi i parë në përcaktimin e pranueshmërisë. Pranueshmëria DDA përcaktohet sipas kapitullit 388-823 WAC.